

L I G J
Nr.7880, datë 1.12.1994

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7504, DATË 30.7.1991 "PËR POLICINË E RENDIT"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7504, datë 30.7.1991, në nenin 38, në paragrafin e dytë, pas fjalëve "të dënuar dhe të internuar" shtohen fjalët "e të dëbuar për motive politike që gëzojnë statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë".

Në këtë nen shtohet edhe një paragraf me këtë përmbajtje:

"Personave që u janë ndërprerë studimet e larta për motive politike ose që gëzojnë statusin e ish-të dënuarve e të përndjekurve politikë, kanë të drejtë të titullohen oficerë me urdhër të ministrit të Rendit Publik".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.975, datë 9.12.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha